



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI PORTUAL Durrës

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Upgrade CISCO CUMC Telefonia” (*Procedure e hapur e thjeshtuar - Mall*)

VLERA E FONDIT LIMIT: 2.468.800 (dy milion e katërqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e tetëqind) lekë, pa TVSH.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

- Platforma kompjuterike 30211300-4
- Sistem elektronik i inteligjencës 35721000-4
- Sistem kontrolli kompjuterik 48151000-1

Afati i lëvrimit të mallrave do të jetë 2 (dy) muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor – Autoriteti Portual Durrës – ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit janë standarte dhe nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*
- Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, i ndryshuar, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriteve të Përgjithshme (sipas shtojcës 8).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP-së i ndryshuar, nenin 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të realizuar për tre viteve e fundit financiare (2022-2023-2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit. *Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 2/c e 55, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % nga vlera e përlogaritur e fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen **vërtetime** të lëshuara nga një ent publik ose **fatura tatimore** të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të furnizimet e realizuara. Faturat të jenë të deklaruara në organet tatimore.
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm **fatura tatimore** të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të furnizimet e realizuara. Faturat të jenë të deklaruara në organet tatimore.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, si dhe në nenin 40, pika 4 e 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për

të zbatuar kontratën me sukses, prandaj është kërkuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast për zgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jete i pajisur dhe të paraqese certifikatat perkatese te vlefshme te ISO-ve, (te perkthyer ne shqip dhe te noterizuara) te leshuara nga organizmat e vleresimit te konformitetit, te akredituara nga DPA, ose organizma nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise, si me poshte.

- a) **ISO 9001:2015 ose ekuivalente**, për menaxhimin e cilësisë, që ka lidhje me objektin e prokurimit.
- b) **ISO 27001:2022 ose ekuivalente**, për menaxhimin e sigurisë së informacionit, që ka lidhje me objektin e prokurimit.
- c) **ISO 20000-1:2018 ose ekuivalente**, për menaxhimin e shërbimeve të teknologjisë së informacionit (e vlefshme)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Duke qene se sistemi pjese e prokurimit eshte i rendesishme per sigurine dhe vijueshmerine e punes te sistemeve kritike ne APD duhet qe subjektet zbatuese te kontrates te jene te pajisura me keto certifikime. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që si kompani kanë kualifikimet/certifikimet e duhura organizative dhe operacionale të nevojshme për të zbatuar kontratën.

- Përbushja e standartit **ISO 9001:2015 ose ekuivalent** është i rendesishem per te siguruar menaxhimin e cilësisë së shërbimeve që kerkohen. Ky lloj certifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka të implementuar një sistem menaxhimi të cilësisë për shërbimet e ofruara dhe zbatimin e kontratës në tërësi e rrjedhimisht dhe përbushjen e saj sipas të gjitha standarteve të cilësisë.
- Përbushja e standartit **ISO 27001:2022 ose ekuivalent** është i rendesishem per te siguruar qe shoqerite zoteroje njohurite si dhe procedurat e menaxhimin te sigurise se informacinoit që kerkohen. Ky lloj certifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka të

implementuar një sistem menaxhimi të sigurse për shërbimet e ofruara dhe zbatimin e kontratës në tërësi e rrjedhimisht dhe përmbushjen e saj sipas të gjitha standarteve të sigurse.

- Përmbushja e standartit **20000-1:2018 ose ekuivalent** është i rëndësishëm për të siguruar menaxhimin profesional dhe të standardizuar të shërbimeve të teknologjisë së informacionit. Ky certifikim garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka të implementuar një sistem të menaxhimit të shërbimeve IT në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare, duke siguruar cilësi, siguri dhe vazhdimësi operacionale gjatë zbatimit të kontratës dhe mirëmbajtjes së sistemeve.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin me sukses të kontratës, duhet të disponojë si staf të tij personelin kryesor teknik, si më poshtë:

a) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për menaxhim të shërbimeve të teknologjisë së informacionit ITIL ose ekuivalent.

Argumentimi:

Kërkesa për të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për menaxhim të shërbimeve të teknologjisë së informacionit ITIL ose ekuivalent është vendosur për të siguruar që operatori ekonomik të zotërojë njohuritë dhe praktikën më të mira ndërkombëtare në administrimin, ofrimin dhe përmirësimin e shërbimeve IT.

Në kuadër të projektit “Upgrade Cisco CUMC Telefonia”, menaxhimi korrekt i shërbimeve IT është thelbësor për garantimin e vazhdimësisë së komunikimit, standardizimin e proceseve, menaxhimin e incidenteve dhe rritjen e efikasitetit operacional.

Një specialist i certifikuar ITIL siguron që proceset e shërbimeve të teknologjisë së informacionit të jenë të dokumentuara, të kontrolluara dhe të përmirësohen vazhdimisht sipas praktikave të standardizuara, duke reduktuar rreziqet dhe ndërprerjet në funksionimin e sistemit të telefonisë.

Ky kriter është proporcional dhe në përputhje me natyrën e kontratës, pasi lidhet drejtpërdrejt me cilësinë dhe qëndrueshmërinë e shërbimit që do të ofrohet.

Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzojë dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, I ndryshuar si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

b) Të pakten 1 (një) specialist të certifikuar për menaxhim projektesh

Argumentimi:

Kërkesa për të paktën 1 (një) specialist të certifikuar në menaxhimin e projekteve është vendosur për të garantuar që operatori ekonomik zotëron kapacitetet profesionale për

planifikimin, koordinimin dhe zbatimin në mënyrë të strukturuar të projektit “Upgrade Cisco CUMC Telefonia”.

Ky projekt përfshin ndërhyrje në infrastrukturën ekzistuese të komunikimit të Autoritetit, integrimi me sistemet aktuale dhe migrim konfigurimesh të ndjeshme, që kërkojnë ndjekje sipas metodologjive të standardizuara të menaxhimit të projekteve (p.sh. PMI, PRINCE2, IPMA).

Prania e një specialisti të certifikuar siguron përdorimin e praktikave të mira për menaxhimin e afateve, burimeve dhe rreziqeve teknike, duke garantuar përfundimin me sukses dhe brenda standardeve të cilësisë të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor.

Ky kriter permbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzojë dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, I ndryshuar si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

c) Të paktën 3 (tre) specialist të certifikuar në nivel profesional nga prodhuesi CCNP për rrjetin ose ekuivalente për të mirëmbajtur infrastrukturën ekzistuese të rrjetit

Argumentimi:

Kërkesa për të paktën 3 (tre) specialistë të certifikuar në nivel profesional CCNP (Cisco Certified Network Professional) ose ekuivalente është vendosur për të garantuar që operatori ekonomik ka kapacitetin teknik dhe ekspertizën e nevojshme për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e infrastrukturës ekzistuese të rrjetit të komunikimit.

Ky nivel certifikimi dëshmon njohuri të avancuara në projektimin, konfigurimin, diagnostikimin dhe optimizimin e rrjeteve të ndërlikuara, si ato që përdoren aktualisht në sistemin Cisco CUMC Telefonia dhe në rrjetin e brendshëm të Autoritetit Portual. Duke qenë se infrastruktura rrjetore është kritike për funksionimin e pandërprerë të shërbimeve IT dhe komunikimit të brendshëm, prania e specialistëve të kualifikuar CCNP siguron ndërhyrje profesionale, menaxhim të sigurt të pajisjeve Cisco dhe ruajtje të performancës e sigurisë së sistemit.

Ky kriter është proporcional me kompleksitetin dhe rëndësinë e kontratës, pasi garanton që mirëmbajtja të kryhet nga personel me njohuri të thelluara dhe të verifikuara sipas standardeve ndërkombëtare të prodhuesit.

Ky kriter permbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzojë dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, I ndryshuar si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

d) Të paktën 2 (dy) specialist të certifikuar në nivel profesional nga prodhuesi CCNP Collaboration ose ekuivalente, për të instaluar dhe konfiguruar shërbimet për upgrade të sistemit të telefonisë.

Argumentimi:

Kërkesa për të paktën 2 (dy) specialistë të certifikuar në nivel profesional CCNP Collaboration ose ekuivalente është vendosur për të garantuar që operatori ekonomik zotëron njohuritë dhe aftësitë e avancuara teknike për instalimin, konfigurimin dhe optimizimin e shërbimeve të telefonisë gjatë procesit të upgrade-it të sistemit Cisco CUMC.

Certifikimi CCNP Collaboration dëshmon përvojë të thelluar në menaxhimin e zgjidhjeve të komunikimit unifikuar (Unified Communications), integrimin e pajisjeve të zërit, video-konferencave dhe shërbimeve të rrjetit të komunikimit.

Duke qenë se projekti përfshin ndërhyrje në një sistem aktiv të komunikimit që përdoret nga të gjitha strukturat e Autoritetit, është thelbësore që puna të kryhet nga specialistë të kualifikuar në mënyrë që të sigurohet funksionim i qëndrueshëm, integrim korrekt me infrastrukturën ekzistuese dhe shmangie e çdo ndërprerjeje të shërbimeve kritike.

Ky kriter është proporcional dhe plotësisht në përputhje me natyrën e kontratës, pasi ndihmon në garantimin e cilësisë, sigurisë dhe besueshmërisë së procesit të përmirësimit të sistemit të telefonisë.

Shënim: Një punonjës mund të ketë më shumë se një certifikim.

Shënim: Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat përkatëse të vlefshme.

Shënim: Personeli i mësipërm duhet të ketë marrëdhënie pune me operatorin ekonomik për periudhën e 3 muorit të fundit, e vërtetuar kjo me formularin e E-sig të listëpagesave dhe kontratave të punës.

Ky kriter permbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzojë dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, I ndryshuar si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

2.3.4 Autorizimi i prodhuesit ose distributorit të autorizuar për territorin e Shqipërisë për produktet e kerkuara. Autorizimi duhet të lëshohet në drejtim të APD dhe në të duhet të ketë informacion të mjaftueshëm për verifikimin e tij. Gjithashtu të vertetohet dhe lidhja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit në rastin kur autorizimi jepet nga distributori i autorizuar.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatën e Partneritetit nga prodhuesi i produkteve.

Argumentimi:

Autorizimi i prodhuesit ose distributorit të autorizuar është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon kanalin zyrtar të origjinës së mallrave/licensimeve specifike që kërkohen në kete prokurim, garanton gjithashtu se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre produkteve. Kjo garanton që produktet që kërkohen të blihen janë prodhuar/krijuar sipas standardeve të larta nga prodhues të njohur zyrtarisht. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për tu garantuar që Operatori Ekonomik ka mbështetjen dhe suportin e prodhuesit ose distributorit të autorizuar për territorin e Shqipërisë për të garantuar cilësinë e produkteve dhe furnizimin e tyre në kohë për përmbushjen me sukses të kontratës, duke garantuar funksionimin e pajisjeve në kushtet e garancisë dhe pas saj.

Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 5 dhe 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

2.3.5 Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit/ve për listën e mallrave objekt prokurimi, në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen.

Shenim: Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i perkasin.

Argumentim: Ky kriter është menduar për të dhënë sigurinë AK që OE ofertues do të paraqesë mallra, të cilët përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike dhe janë në përputhje me to. Kriteri i kërkuar në lidhje me katalogun e prodhuesit/prodhuesve, është vendosur në përputhje me pikën 6/b, të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar.

2.3.6 Operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin Dokumentin e titulluar Ofertë Teknike të ngarkuar në SPE nga Autoriteti Kontraktor në formën e një tablele kërkesat e të cilit duhet të plotësohen rigorozisht nga Ofertuesi artikujt e Listës. Oferta teknike duhet të përmbajë të dhënat si më poshtë:

- a. Emri i kompanisë prodhuese ose distributori i autorizuar nga prodhuesi me produktet e të cilëve Operatori Ekonomik do të paraqitet në dokumentat e ofertimit. Adresa dhe web-siti të sakta të kompanisë prodhuese ose distributorit të autorizuar.
- b. Emërtimi i Katalogut të prodhuesit.
- c. Nr. i faqes në katalog referuar Nr. Identifikues të artikullit të ofruar sipas listës të shënuar me një shenjë dalluese.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Argumentimi i specifikimeve teknike: Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë, për blerjet e reja cilësore, kërkesat aktuale për funksionalitet zgjerim cilësi e performancë si dhe shërbimet profesionale të kërkuara për teknologjite ekzistuese, ofrimin të

produkteve të reja, karakteristikat e duhura bashkëkohore teknologjike, standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.